

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionërit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.12.2024*

**11.12.2024
Ora 15:04**

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve me aftësi të kufizuar, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025”.

PJESËMARRJA :

KQZ:


- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- Staf i KQZ: Znj. E. Allushi, znj. P. Doçaj, znj. D. Alimemeti.
Parti Politike: PD (z. F. Nuri), PL (z. K. Kolndreu)
Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve, atëherë në seancën e sotme publike, kemi në rendin e ditës:

- Shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025”.
- Projektvendim “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve me aftësi të kufizuar, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025”.
- Projektvendim “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të pakicave kombëtare, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025”.

Nga seancat e tjera publike të shkuara kemi të mbartura:

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionërit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.12.2024*

- Projektvendim “Për miratimin e gjetjeve të raportit për vlerësimin e veprimtarisë së operatorëve, të paisjeve elektronike të votimit dhe numërimit në bashkitë: Kamëz, Vorë dhe Elbasan, për zgjedhjet e datës 14 maj 2023”, si dhe:

- Projektvendimin “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Erin Gjoni, anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Sociademokrate”.

Fillojmë me tre pikat e para të rendit të ditës që kanë të bëjnë me miratimin e programeve të edukimit dhe informimit të zgjedhësve për zgjedhjet e datës 11 maj 2025. Programin e përgjithshëm dhe dy programet e posaçëm. Programi për personat me aftësi të kufizuar dhe programi për pakicat kombëtare. Shkurtimeisht në mënyrë të përmbledhur për të tre programet, Ermina!

Znj. E. Allushi: Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “g” të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Drejtoria e Komunikimit ka hartuar tre programe. Programi i parë është i përgjithshmi për informimin, ndërgjegjësimin e zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj. Ky program synon ndërgjegjësimin për pjesëmarrjen në votim dhe informimin e zgjedhësve të të gjithë hapave të procesit zgjedhor. Është i ndarë në dhjetë pjesë, dhjetë objektiva kryesorë. Të ndara duke filluar nga informimi i zgjedhësve për veprat penale në zgjedhje, kontrolli i emrit në listë dhe të gjithë pjesët e tjera, objektivat e tjerë. Ky projektvendim është ndarë dhe me grupet e interesit, partitë politike dhe kemi marrë disa sugjerime të cilat janë reflektuar në program. Më pas kemi hartuar dhe programin e edukimit për personat me aftësi të kufizuar ku gjithmonë mbështetur në nenin 19, pikat 1, shkronja “g” të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, por dhe vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, vendimi nr. 221 i vitit 2022, ku për herë të parë është hartuar një program i posaçëm dedikuar personave me aftësi

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionërit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.12.2024*

të kufizuar. Ky akt është ndarë dhe programi është hartuar me organizata të shoqërisë civile që mbrojnë interesat e këtij target grupi. Gjithashtu është ndarë dhe me grupet e interesit ku të gjitha sugjerimet që janë të përshtatshme për t'u reflektuar në program, janë reflektuar. Më pas është hartuar programi i dedikuar pakicave kombëtare ku gjithmonë në zbatim të nenit 19, pikat 1, shkronja "g" e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, vendimi nr. 222 i vitit 2022 është hartuar një program dedikuar për pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë. Ky program është ndarë në nëntë objektiva, ku bazuar në nëntë pakicat kombëtare që jetojnë në Shqipëri. Edhe ky program është ndarë me grupet e interesit që mbulojnë... me vetë komitetin e pakicave kombëtare dhe organizata të shoqërisë civile që përfaqësojnë këto pakica. Kanë sjellë disa sugjerime të cilat janë reflektuar në program. Për sa më sipër të tre programet për miratimin tuaj.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Përfaqësues të partive politike në lidhje me këto tre programe? S'kemi! Mirë dakord, i miratojmë të tre programet, si atë të përgjithshmin për informimin, edukimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve. Gjithashtu dhe dy programet e veçanta, atë për pakicat kombëtare dhe personat me aftësi të kufizuar.

Vendimi nr. 206, 207, 208

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionërit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.12.2024*

11.12.2024
Ora 15:09

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për miratimin e raportit mbi gjetjet pas vlerësimit të regjistrimeve filmike gjatë implementimit të votimit elektronik në bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- Stafii KQZ: Znj. E. Allushi, znj. P. Doçaj, znj. D. Alimemeti.
- Parti Politike: PD (z. F. Nuri), PL (z. K. Kolndreu)
- Të tjerë: KRIIK
- Operatorë të QV-ve: Z. Arbër Çengo, QV Paloq, Prezë.
Z. Elida Sina, QV Mollagjesh, Elbasan.
Z. Osmon Deda, Vorë.
Z. Fialdo Mema, Elbasan.
Z. Vilson Fejzo, Elbasan.

Z. I. Celibashi: Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës që ka të bëjë me miratimin e gjetjeve të raportit për vlerësimin e veprimtarisë së operatorëve, të paisjeve elektronike të numërimit dhe votimit për zgjedhjet e datës 14 maj 2023, për bashkitë: Kamëz, Vorë dhe Elbasan. Po, shkurtimisht Daniela!

Znj. D. Alimemeti: Në referim të nenin 19, pikat 1 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, në referim të nenit 22, pika 1 të Kodit Zgjedhor, në referim të vendimit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionërit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.12.2024*

të Komisionit Rregullator nr. 4 të vitit 2020 dhe vendimit nr. 16, dt.13.04.2023, paraqitet për miratim raporti i gjetjeve për votimin elektronik në zgjedhjet e 14 majit 2023. Në raportin për implementimin e votimit elektronik, në bashkitë: Kamëz, Vorë dhe Elbasan për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, janë përfshirë në detaje proceset si, procesi përgatitor i votimit elektronik, dita e zgjedhjeve, problemet e identifikuar si dhe rekomandime për përmirësim. Në lidhje me procesin përgatitor, raporti liston në mënyrë të detajuar disa personalizime dhe përmirësime teknike që kanë të bëjnë me softwerin e votimit elektronik duke synuar përmirësimin dhe funksionalitetin e sigurinë e procesit. Personalizimet kanë përmirësuar përputhshmërinë e votimit elektronik me atë tradicional duke lehtësuar procesin e përgatitjes si dhe eksperiencën e votuesve. Gjithashtu në kreun e procesit të përgatitjes së votimit elektronik trajtohen në mënyrë të detajuar dhe pjesë të procesit përgatitor që janë konfigurimi i fletës së votimit dhe raportet, trajnimi i operatorëve, edukimi dhe informimi i zgjedhësve, si dhe testimi i paisjes. Në procesin e trajnimit, raporti paraqet hapa të detajuar për përgatitjen e operatorëve të PEVN-së duke synuar zbatimin efikas të teknologjisë në zgjedhje. Për të siguruar cilësinë e trajnimeve janë zhvilluar trajnimet me trajnerët, trajnime me mbikqyrësit dhe trajnimet e operatorit sipas një kalendari të përcaktuar dhe të detajuar. Trajnimi i operatorëve ishte i bazuar në një kurrikul të mirorganizuar që përfshinte njohuri teorike dhe funksionimin e paisjeve me ushtrime praktike dhe përdorimin e tyre në kushte reale. Gjithashtu nëpërmjet simulimeve të situatave të ndryshme është theksuar identifikimi dhe zgjidhja e problematikave që mund të shfaqeshin gjatë procesit të votimit sidomos dhënia e suportit për votuesit, kur do të kërkohej. Në vijim të procesit përgatitor në raportin me detaje mbi edukimin dhe informimin e zgjedhësve si dhe testimin e paisjeve UAT destine operacional, gjatë ditës së zgjedhjeve në raport me statistikat e gjeneruara nga helpdesk, si numrin e biletave si

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionërit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.12.2024*

dhe problematikave që kanë marrë zgjidhje gjatë ditës së votimit. Në përfundim të procesit të votimit raporti përmbant informacion mbi tabulimin e rezultatit paraprak dhe metodologjinë e përdorur për të gjeneruar këtë rezultat. Më tej raporti jep problematikat e identifikuar gjatë vëzhgimit të bërë si, vështirësia e zgjedhësve në përdorimin e teknologjisë, sidomos në zonat rurale, në zbatimin e udhëzimeve të dhëna nga trajnierët në trajnimin me operatorët, si dhe problematika të tjera logjistike. Gjithashtu në raport përfshihen të detajuara nga vëzhgimet e kamerave në qendrat e votimit, shkeljet e dokumentuara të operatorëve për çdo QV të veçantë. Në total kemi 17 operatorë që rezultojnë me shkelje duke përfaqësuar 2.1% të QV-ve ku është përdorur votimi elektronik. Në përfundim raporti jep rekomandime për përmirësimin e procesit. Për sa më lart në këtë relacion Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve të afateve ligjore, i propozohet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për miratimin e raportit të gjetjet pas vlerësimit të regjistrimeve filmike gjatë implementimit të votimit elektronik në bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”. Gjithashtu t’i propozojë KAS vendosjen e sanksioneve administrative, ndaj operatorëve të paisjes elektronike të votimit dhe numërimit, përgjegjës për shkeljet e konstatuara në raport, sipas nenit 171 të Kodit Zgjedhor.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesi i Partisë Demokratike, në lidhje me çështjen!

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Faleminderit zoti Komisioner! Në lidhje me raportin, mbi gjetjet e PEVN për zgjedhjet e majit 2023, ne u njohëm me këtë raport dhe konstatojmë, po e marr që në fillim, me pjesën e paisjeve dhe personalizimin, apo


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionërit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.12.2024*

përmirësimin e paisjeve që pretendohet se ka ndodhur. Ne kemi ngritur shqetësimin dhe herë të tjera dhe po e ripërsërisim që në zgjedhjet e vitit të shkuar, problem që u evidentua dhe gjatë ditës së votimit, ishte pamundësia e zgjedhësve për të anuluar fletën e votimit që printohej në momentin kur zgjedhësi bënte seleksionimin e tij në aparat. Kjo mundësi ne gjykojmë që i duhej dhënë zgjedhësve. Pra, në momentin që zgjedhësi konstatonte që bënte zgjedhjen e tij në ekran dhe konstatonte se nga printeri në kutinë elektronike të votimit nuk përputhej zgjedhja e tij, do të ishte e udhës që të jepej mundësia e anulimit të fletës së votimit, ashtu sikundër ndodh edhe me procesin fizik, kur fleta dëmtohet, psh dhe jepet mundësia votuesit të ketë një fletë të dytë votimi. Fakti që me këtë teknologji nuk u arrit në zgjedhjet e shkuara që të jepej kjo mundësi ne gjykojmë se është një minus dhe një element që do të duhej të përfshihej. Për sa i takon pjesës së trajnimeve, patjetër që ndoshta trajnimet janë kryer, ka pasur trajnime të bollshme, rezultati në ditën e zgjedhjeve tregoi, flas për rezultatin e procesit të votimit, tregoi që pati problematika të mëdha dhe të theksuara në tre këto bashki: Elbasan, Kamëz dhe Vorë, ku u implementua votimi elektronik. Problematika të theksuara që ne i kemi ngritur si përfaqësues këtu përpara KQZ-së, përpara KAS-it po ashtu, apo Kolegjit Zgjedhor në lidhje me ecurinë e procesit të votimit, sepse pati votime familjare. Pati votime në grup, me dhjetra raste në të gjitha këto bashki për të cilat ne arritëm të gjejmë prova, për aq pak kohë që patëm në dispozicion. Për ato materiale video që na u vunë në dispozicion në atë periudhë të vitit të kaluar, për ato prova të brendshme që i sollëm përpara jush, para KQZ-së, ku u evidentua votimi familjar, ku pati pa fund raste që personat që duhet të asistojnë në procesin e votimit apo të orientojnë operatorët e ndryshëm, ndërhyjnë, afroheshin pranë pajisjeve të votimit më tepër se sa distanca e lejuar. Ka pasur raste që kanë prekur edhe ekranin për të mos thënë që kanë votuar në vend të zgjedhësve, apo kanë orientuar zgjedhësit edhe për kë të votojnë. Pra, të gjitha këto, ne gjykojmë që janë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionërit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.12.2024*

jo thjesht incidente të vogla, por shkelje të rënda që kanë ndodhur vitin e shkuar dhe do të duhej që masat administrative, po pse jo dhe masat penale të ishin në raport adekuat me ato shkelje. Por do dal aty në fund të fjalës sime. Një element tjetër që dua të theksoj është pse jo edhe problematika që është evidente edhe me kamerat. Në raport ju si KQZ keni shprehur mjaft qartë që këto gjetje bazohen mbi ato kamerat që ishin funksionale dhe mund të shfrytëzoheshin me pak fjalë, sepse e keni lënë të qartë në raport, e keni shkruar mjaft qartë në raport se ka pasur qendra votimi ku kamerat nuk kanë qenë funksionale. Ne si subjekt politik, Koalicioni “Bashkë fitojmë” në zgjedhjet e majit 2023, kur kemi bërë kërkesat ankimore dhe kemi kërkuar vënien në dispozicion të kamerave për qendra votimi të caktuara në Elbasan, në Kamëz e me radhë, kemi konstatuar një numër mjaft të lartë rastesh ku kamerat ishin të pashfrytëzueshme, ose kamera dilte me ekran të zi dhe nuk shihej fare se ç’ndodhte në qendrën e votimit, ose ishte imazhi i papërshtatshëm dhe nuk kuptohej. Ka pasur raste kur kamera ishte e orientuar keq, në kuptimin që këndi i filmimit nuk të lejonte të shihje totalisht se çfarë ndodhte në sallën, në ambientin e votimit, të shkollës, qendrës shëndetësore e me radhë, ku kryhej votimi. Pra, ne jemi të mendimit që dhe këto raste duhet të sjellin pasoja administrative dhe pse jo penale për personat që të mbajnë përgjegjësi. Ata persona që nuk kanë mundur që të plotësojnë të gjitha kriteret ligjore, sepse sot ne dhe ju nuk kemi mundësi që të kryejmë një raport 100% të saktë, mbi 100% të qendrave të votimit, por kemi reduktuar raportin me ato qendra ku keni pas mundësi të shfrytëzoni efektivisht pamjet filmike. Në fund për ekonomi, nuk po zgjatem, dua ta mbyll me numrin e rasteve që KQZ-ja propozon sanksione në KAS, për sanksione administrative, theksoj. Ne na duket një numër mjaft i ulët. Numri i propozuar në mos gaboj nuk kalon shifrën 17 apo jo? Dy në Bashkinë e Vorës, tre në Bashkinë e Kamzës dhe një shifër rreth dymbëdhjetë apo trembëdhjetë në Bashkinë e Elbasanit, në mos

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionërit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.12.2024*

gabohem, që është një shifër mjaft e ulët 2.1%, po ta bëjmë me përqindje. Ju në raport jeni shprehur se në 2.1% të rasteve keni evidentuar shkelje për të cilat do t'i referoheni dhe KAS-it. Ne mendojmë se është një shifër mjaft e ulët në total, jemi te vlerësimi se kjo shifër duhet të jetë shumë e lartë në realitet. Shkeljet nuk kanë ndodhur vetëm në 2.1% të qendrave të votimit në vlerësimin tonë në këto tre bashki, por ka pasur shkelje administrative dhe penale në shumë qendra të tjera, në dhjetra, dhjetra qendra të tjera. Materialet dhe provat e këtyre ne i kemi depozituar që vitin e kaluar në KAS dhe në KQZ, po dhe në Kolegj Zgjedhor, të paktën për dy nga këto bashki që i kemi ndjekur mjafton t'i referoheni atyre dhe mund të gjeni materiale të bollshme për të argumentuar këtë fakt. Si përfundim, ne do të kërkonim nga KQZ-ja, jo vetëm të limitonit ndjekjen e sanksioneve administrative por do të donim gjithashtu që KQZ-ja të kishte edhe një listë të detajuar të kallëzimeve penale, që të jenë adresuar si institucion nga ju, mund t'i adresohen Prokurorisë dhe SPAK-ut në lidhje me shkeljet dhe krimet zgjedhore që kanë ndodhur vitin e kaluar. Pra, këto janë në thelb kërkesat e subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po faleminderit ju! Kemi diskutime të tjera? Nuk kemi. Mirë, dakord. Atëherë për ta përfunduar nëse nuk keni ndonjë gjë tjetër. Ka ndonjë prej operatorëve, keni njoftuar? Atëherë janë prezent një pjesë? Do dikush, ndonjëri prej jush të flasë? Nuk dëshironi të flisni, gjithsesi faleminderit për prezencën, besoj me raportin jeni njohur që jeni këtu prezent.

Z. K. Kolndreu, përfaqësues i PL: I nderuar zoti Komisioner, unë nuk jam njohur fare me raportin.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionërit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.12.2024*

Z. I. Celibashi: Ju jeni përfaqësues i Partisë së Lirisë. Ne jua kemi përcjellë raportin me email, nuk e di, nuk e keni marrë?

Z. K. Kolndreu, përfaqësues i PL: Jo.

Z. I. Celibashi: Do tëdoni që ta shtyjme, që të njiheni me raportin?

Z. K. Kolndreu, përfaqësues i PL: Jo nuk ka problem.

Z. I. Celibashi: Në rregull! Po, atëherë isha duke thënë që në vlerësim të atyre gjetjeve që ne kemi mundur t'i kemi të tilla nga vlerësimi i pamjeve filmike, rezulton ky numër dhe kjo natyrë shkeljesh. Konstatimi i përfaqësuesit të Partisë Demokratike, qëndron për një numër qendrash votimi në të cilat nuk është kryer procesi i monitorimit nëpërmjet kamerave monitoruese dhe me siguri që do të duhet ta adresojmë dhe jemi duke punuar për ta adresuar këtë problematikë në të ardhmen për të evidentuar qartë se çfarë do të duhet të ishte bërë dhe çfarë do të duhet të bëhet në të ardhmen. Kjo nuk do të thotë që ne e përfundojmë këtu çështjen e vlerësimit të sjelljes së pjesës tjetër të administratës zgjedhore dhe konkretisht për mënyrën e funksionimit të kamerave. Ndoshta do të duhet të bëjmë një vlerësim edhe për këtë rast, për të parë se për çfarë arsyesh këto kamera nuk kanë funksionuar në disa qendra votimi, sepse qartësisht mungesa e funksionimit të tyre ka ndikuar dhe në numrin e gjetjeve. Mund të ishin dhe kaq, por ne nuk e themi dot me siguri absolute, kështu që do të duhet ta shohim edhe këtë aspekt, Daniela. Por, për aq sa kemi mundur të verifikojmë, mendojmë që për këto shtatëmbëdhjetë qendra votimi në vlerësimin dhe në gjykimin tonë, shkeljet janë evidente dhe tej asaj, pa i hyrë rrethanave të tjera, por qartësisht veprimtaria e operatorëve në këto qendra votimi,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionërit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.12.2024*

në këto shtatëmbëdhjetë qendra votimi është në kundërshtim me protokollin e miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Ndaj e gjej me vend që:

- për operatorët e qendrave të votimit: 1546, 1549, 1563 në Vorë, 2449, 2343, 2379, 2381, 2383, 2383/01, 2390, 2407, 2421, 2433, 2481, 2432 të Bashkisë Elbasan dhe 1589 dhe 1600 të Bashkisë Kamëz t'i propozohet KAS-it vendosja e sanksioneve administrative.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, jo ndaj këtij vendimi nuk ka ankim sepse është propozim për vendosje sanksioni në KAS dhe fuqinë ky akt e merr pasi KAS-i të vendosi. Përtej kësaj, në vijim të asaj që tha përfaqësuesi i Partisë Demokratike, ky në vendim nuk na pengon për të vazhduar, për të verifikuar më tej dhe për të vlerësuar më tej nevojën, apo vendin për sanksione të tjera, apo për procedime të tjera nëse do të jetë rasti. Faleminderit!

Vendimi nr. 209

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

